

Paketë informuese

SEKTORI I AGROBIZNESIT



Mbeshtetur nga:

Përmbajtja

1	Panoramikë e përgjithshme e industrisë	
3		
2	Përmbledhje e sistemit të taksave dhe tatimeve në sektorin e turizmit	4
2.1.	Vështrim i përgjithshëm mbi tarifatat dhe taksat	
4		
2.2.	Tarifa dhe taksa specifike për industrinë	
6		
2.3.	Skema e kompensimit e prodhuesve bujqësorë	
7		
3	Skemat mbështetëse të biznesit në këtë industri dhe procedurat për të përftuar prej tyre (qeveritare apo donatorë të ndryshëm)	8
3.1.	Skema Kombëtare	
8		
3.2.	Programi IPARD 11	
9		
3.3.	Programi AZHBR	
11		
3.4.	Produktet financiare ekzistuese për agroturizmin nga bankat dhe institucionet financiare në Shqipëri	
12		
4	Shërbimet e zyrës së punësimit, në raport me punëdhënësit dhe punëmarrësit	
13		
4.1.	Programi i punëve publike në komunitet	
13		
4.2.	Programi i punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19 nga data 10 mars 2020 deri në datën 23 qershor 2020, nëpërmjet financimit të sigurimeve të detyrueshme.	
15		
4.3.	Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet vetëpunësimit	
16		
4.4.	Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale	
16		
4.5.	Programet të tjera	
17		
Shtojca 1		
20		

01

PANORAMIKË E PËRGGJITHSHME E INDUSTRIËS

Bujqësia mbetet një nga sektorët me potencial më të madh në Shqipëri. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, kontributi i këtij sektori në prodhimin e brendshëm bruto në vitin 2019 ishte rreth 18.6% duke pasur një rritje me 1.35% në terma realë. Gjithashtu, ky sektor dominon tregun e punësimit duke zënë 43.5% të të punësuarve për vitin 2019.

Në tabelën më poshtë tregohet ecuria e prodhimit bujqësor gjatë periudhës 2015-2019.

Gjatë vitit 2019 vihet re një tendencë në rritje e prodhimit bujqësor. Prodhimi i perimeve dhe i drufrutorëve është rritur gjatë 2019, në krahasim me 2018, respektivisht me 7.9 % dhe 0.6%.

Në tabelën më poshtë tregohet ecuria e prodhimit bujqësor gjatë periudhës 2015-2019.

PRODHIMI BUJQËSOR	2015	2016	2017	2018	2019
Bimët e arrave					
Drithëra	695,5	698,4	707,7	680.780	666,1
Perime	1.030,0	1.129,1	1.151,9	552.638	1.258,0
Patate	245,0	238,3	249,8	254,5	260,7
Fasule	28,0	25,0	21,2	24,5	24,8
Bime industriale	-	-	32,7	30,8	33,7
Bime medicinale	10,8	10,6	12,8	12,5	12,9
Foragjere	6.000,0	6.144,0	6.688,6	7.050,1	7.115,2
Drufrutorët					
Pemë frutore	245,0	261,0	-15,7	274,3	272,6
Ullijn	96,0	99,0	-7,0	117,6	98,3
Agrume	30,0	40,0	-0,4	45,5	46,9
Gjithsej	205,0	205,1	2,9	184,8	184,8

Tabela 1. Prodhimi bujqësor (mijë tonë)

Produktet bujqësore shqiptare kërkohen në vende, të tilla si Italia, Franca, Belgjika, Zvicra,

Evropa Lindore dhe SH.B.A. Kryesisht produktet vendase që konkurrojnë në tregun e huaj janë frutat dhe perimet, peshku i freskët dhe i përpunuar, bimët medicinale dhe aromatike, vaji i ullirit, mjalti, etj. Në Shqipëri eksportohet 75% e peshkut dhe 99% e bimëve medicinale dhe aromatike gjithashtu. . Bimë të tjera medicinale dhe aromatike të kultivuara dhe të përpunuara në Shqipëri përfshijnë livandon, murrizin,, manaferrat e dëllinjës, boronicën, farën e gjembaçit, kamomilin, çajrat bimore, borzilokun, lulediellin, etj.

Frutat dhe perimet

Referuar sasisë së produkteve të eksportuara, frutat dhe perimet janë në krye të listës së produkteve të eksportuara shqiptare. Përgjithësisht këto produkte furnizojnë tregun vendas dhe por dhe vendet e tjera të rajonit, të tilla si Kosova, Serbia, Bullgaria, Mali i Zi, Lituania, etj.

Sherebeli shqiptar

Sherebeli shqiptar përbën 70% të sherebelës që eksportohet në SH.B.A., ndërsa tregjet e tjera ku eksportohet ky produkt janë Franca, Gjermania dhe Itali.

Lavanderi

Lavanderi prodhohet në Shqipëri, por në shumë pak pjesë të vendit, si: Koplik në rrethin Malesi e Madhe, në fshatrat e Elbasanit, etj. Dy tregjet më të mëdha ku eksportohet ky produkt janë Gjermania dhe Italia, por dhe në tregjet e tjera si Turqia dhe Franca.

Domatja

Në vitin 2018, Shqipëria u rendit në vendin e parë në rajonin e Ballkanit, në lidhje me eksportimin e domateve me një vlerë totale prej 28.9 milion € të ardhura. Kjo e vendos Shqipërinë në vendin e 22-të në një nivel botëror.

Në lidhje me produktet bujqësore, Shqipëria aktualisht furnizon vetëm 30% të kërkesës së tregut vendor dhe ka një potencial të madh në këtë sektor.

Burimi: <https://invest-in-albania.org/industries/agriculture/>

02

PËRMBLEDHJE E SISTEMIT TË TAKSAVE DHE TATIMEVE NË SEKTORIN E AGROBIZNESIT

Seksioni më poshtë paraqet një panoramikë të përgjithshme të tarifave dhe taksave të aplikuar në Republikën e Shqipërisë.

2.1. Vështrim i përgjithshëm mbi tarifat dhe taksat

▪ Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR		
Norma Standarte	20%	Aplikohet për të gjitha bizneset që tejkalojnë pragun prej 5 milion lekësh (afërsisht 36,700 EUR) ¹ .
Normë e reduktuar	0%/6%	Eksportet, etj
Përfshijtura		- Shërbime postare, - Shërbime shëndetësore; - Ndihma sociale; - Shërbime edukative; - Shërbime financiare dhe sigurimesh; - Etj
Periudha e rimbursimit	30/60 ditë	Tatimpaguesi mund të aplikojë për rimbursim të TVSH-së vetëm nëse bilanci i TVSH-së i kalon 400,000 lekë dhe është mbartur për më shumë se 3 muaj radhazi. Periudha e rimbursimit kryhet brenda 30 ditëve për eksportuesit dhe 60 ditë për tatimpaguesit e tjerë.
Të tjera mbi		Periudha standarde e TVSH-së është 1 muaj dhe deklarimet mujore standarde të TVSH-së përbëhen nga librat e TVSH-së dhe deklarata e TVSH-së.

▪ Tatimi mbi të Ardhurat

Shkalla aktuale e Tatimit mbi fitimin në Shqipëri është një normë e sheshtë prej 15%. Tatimi mbi fitimin përlogaritet nga tatimpaguesi duke rregulluar fitimin kontabël për të gjithë të ardhurave e patatueshme dhe shpenzimet e pazbritshme.

Normat e mëposhtme të tatim fitimit janë të aplikueshme: ²

¹ Duke filluar nga viti 2021, kufiri minimal për aplikimin e TVSH-së është 10 milion lekë (afërsisht 80,645 EUR).

² Duke filluar nga 2021, normat tatimore ndryshojnë si në vijim:

- 0% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.
- 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.

QARKULLIMI VJETOR (ALL)		NORMA E TATIMIT
Nga	Në	
0	14,000,000	5 %
14,000,001	dhe mbi	15%

Periudha tatimore fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.

▪ **Tatimi në burim**

Të gjitha njësitë rezidente në Republikën e Shqipërisë janë të detyruar të mbajnë tatimin në masën 15% nga pagesat e mëposhtme bruto me burim në Republika e Shqipërisë, përveç nëse një Marrëveshje për Tatimin e dyfishtë parashikon ndryshe:

- ndarjet e fitimit;
- interesat;
- pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale;
- pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit;
- pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues;
- pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to;
- pagesat për qeratë;
- pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre.

Lidhur me tatimin mbi dividendin, shkalla e aplikueshme është 8%.

▪ **Tatimi mbi të ardhura personale dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore**

Tatimi mbi të ardhurat paguhen mbi të ardhurat që individët realizojnë nga burime të ndryshme në Shqipëri dhe / ose jashtë saj gjatë një viti kalendarik.

Tatimi mbi të ardhurat personale në Shqipëri aplikohet në një shkallë progresive si më poshtë:

BAZA E TATUESHME	NORMA
ALL 0- 30,000	0%
ALL 30,001 - 150,000	13% për shumën mbi 30,000 lekë
Mbi 150,001 lekë	15,600 lekë + 23% të shumës mbi 150,000 lekë

Punonjësit, të vetëpunësuarit, punëdhënësit dhe personat e tjerë që marrin të ardhura të rregullta nga burime të ndryshme, i nënshtrohen Kontributeve Sociale dhe Shëndetësore në tarifat e mëposhtme:

	NORMA E SIGURIMEVE SHOQËRORE	NORMA E SIGURIMEVE SHËNDETËSORE
Punëdhënësi	15%	1.7%
Punëmarrësi	9.5%	1.7%
Total	24.5%	3.4%

Të vetëpunësuarit paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat përbëhen nga 3.4% sigurime shëndetësore për dyfishin e pages minimale mujore, si dhe 23% të pages minimale mujore sigurime shoqërore

2.2. Tarifa dhe taksa specifike për industrinë.

Shkalla që aplikohet për tatim fitimin është 5% për subjektet që zhvillojnë veprimtari të certifikuara si "Agroturizëm".

Për strukturat të cilat zhvillojnë veprimtari të certifikuar si "agriturizëm" aplikohet shkalla e redaktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6% për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe të restorantit.

Po ashtu përjashtohen nga TVSH kur importohen i makinave dhe inputeve bujqësore.

Përjashtohen nga pagesa e Taksës së ndikimit në infrastrukturë investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm".

Tatimpaguesi përjashtohet nga pagimi i taksës së pasurive të paluajtshme për tokën bujqësore për pesë vjet, toka bujqësore është e mbjellë me pemë frutore dhe vreshtari

Norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë është 6%.

Shkalla që aplikohet lidhur me tatim-fitimin

Shkalla e tatim fitimit është ulur nga 15% në 5% për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, të cilat operojnë sipas ligjit nr. 38/2012.

Për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %. Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin "subjekt i certifikuar agroturizmi", deri më 31 dhjetor 2021.

Aplikimi i shkallës së reduktuar fillon në vitin tatimor pasardhës, pas përfitimit të statusit "subjekt i certifikuar agroturizmi".

Burimi: Neni 28, LIGJ nr 8438 date 28.12.1998 Per tatimin mbi te ardhurat i ndryshuar

Shkalla që aplikohet lidhur me TVSH-në

Për strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, aplikohet shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit, me përjashtim të pijeve. Personi i tatueshëm, që aplikon shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind, është personi i regjistruar me NIPT/NUIS, vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar si "agroturizëm". Përjashtohen nga TVSH importimi i: Makinerive dhe pajisjeve bujqësore, për regjimin e përpunimit të brendshëm dhe agrobiznesin.

Burimi: Neni 49, Ligj Nr. 92_2014 datë 24.7.2014 Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar

2.3. Skema e kompensimit e prodhuesve bujqësorë

Norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë është 6%.

Prodhuesit bujqësorë përfitojnë të drejtën e kompensimit kur:

- a)** qarkullimi vjetor i tyre nuk tejkalon kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
- b)** furnizojnë mallra apo shërbime me prejardhje nga puna e tyre e kryer në njërin nga aktivitetet e përcaktuarasi mallra apo produkte bujqësore
- c)** mallrat dhe shërbimet u furnizohen personave të tatueshëm që nuk përfitojnë nga skema e kompensimit në Republikën e Shqipërisë;
- d)** janë pajisur me një numër identifikimi të personit të tatueshëm, lëshuar nga Drejtoria

Rajonale Tatimore ku ushtron aktivitetin prodhuesi bujqësor.

Si më poshtë është lista e aktiviteteve bujqësore:

- a)** bujqësia e përgjithshme, përfshirë vreshtarinë;
- b)** pemëtaria (përfshirë olivokulturën) dhe hortikultura (perimet, lulet dhe bimët zbukuruese), edhe në serra;
- c)** prodhimi i kërpudhave dhe i erëzave, i farërave dhe filizave;
- d)** prodhimi i fidanëve.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektarë, në pronësi të tatimpaguesit. Ai varion në bazë vjetore nga 700 në 5,600 lekë për hektar. Kur toka bujqësore është e mbjellë me pemë frutore dhe vreshtari, tatimpaguesi përjashtohet nga pagimi i taksës së pasurive të paluajtshme për tokën bujqësore për pesë vjet.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit

Burimi: [Neni 27, Ligj nr.9632 datë 30.10.2006 -Për sistemin e taksave vendore-](#) i ndryshuar

Ne Shtojcen I janë paraqitur kriteret për certifikimin e veprimtarisë pritëse si "Agroturizëm" dhe të dhëna mbi certifikatën që duhet të pajisen subjektet e agroturizmit

03

SKEMAT MBËSHTETËSE TË BIZNESIT NË KËTË INDUSTRI DHE PROCEDURAT PËR TË PËRFTUAR PREJ TYRE (QEVERITARE APO DONATORË TË NDRYSHËM)

Sa më poshtë paraqet një përmbledhje të skemave të financimit në vëndin tonë:

1. Skema Kombëtare për bujqësinë. Për cdo vit kur përgatitet buxheti i shtetit përcaktohet fondi që do të alokohet për të mbështetur zhvillimin e bujqësisë.
2. Programi IPARD II u ofron ndihmë vendeve kandidate të BE-së për zbatimin e programeve shumëvjeçare që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe zonave rurale dhe përgatitjen e tyre për zbatimin e politikave të BE-së. Buxheti i përgjithshëm indikativ në kuadër të Programit IPARD II është gjithsej 94,337,255 EURO nga të cilat 71,000,000 EURO është kontributi i BE dhe 23,337,255 EURO është kontributi kombëtar.
3. Programi AZHBR , ku banka të ndryshme në vend në bashkëpunim me Agjensinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ofron skema të financimit për mbështetjen e bizneseve bujqësore (prodhuese dhe agropërpunuese), ku subvencionohet norma e interesit të kredisë nga (AZHBR).
4. Produktet financiare ekzistuese për agroturizmin nga bankat dhe institucionet financiare në Shqipëri.

3.1. Skema Kombëtare

Në vitin 2014, Qeveria Shqiptare miratoi programin për “Strategjinë Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020”, me qëllim mbështetjen, promovimin dhe zhvillimin e zonave rurale dhe bujqësisë, e reflektuar në një rritje të buxhetit nga viti në vit, duke arritur në plot 20 milion Euro të buxhetuara në vitin 2018, në formë subvencionesh dhe grantesh.

Për cdo vit kur përgatitet buxheti i vitit përkatës përcaktohet Fondi i Programit Për Bujqësinë e Zhvillimin Rural. Për vitin 2020 Skema Kombëtare e Mbështetjes së Bujqësisë, adreson një fond prej 7 miliardë lekë nga buxheti i shtetit në mbështetje të fermerëve. Afati I fundit për të aplikuar në këtë skemë ka qenë 19 qershori.

Si mëposhtë janë kriteret e përgjithshme të përfitimit:

- Aplikanti duhet të jetë shqiptar ose kompani me bashkëpronësi, njëra nga të cilat të jetë shqiptare
- Fermerët individual të jenë të pajisur me NIPT/NIUS me status aktiv
- SHBB-të, personat fizikë dhe juridikë të jenë të pajisur me NIPT/NIUS me status aktiv
- Aplikantët duhet të mos jenë debitorë AZHBR, MZHBR, Tatimeve dhe duhet të kenë paguar Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore
- Për investimet, ofertat/valutat do të përdoret kursi I këmbimit I BSH në datën e hapjes së aplikimeve
- Për masat mbështetëse direkte që kërkohen faturat/aktet e zhdoganimit duhet të jenë të lëshuara gjatë vitit 2020, në përmbushje me kërkesat e masës përaktëse.
- Për masën mbështetëse të investimeve, punimet dhe faturat/aktet e zhdoganimit duhet të jenë pas datës së lidhjes së kontratës.
- Të gjitha materialet/pajsisjet duhet të jenë të reja,
- Për masën mbështetëse të investimeve, në rastin e ndërtimeve/rikonstruksioneve, duhet të ketë lejen përkatëse të ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi, para lidhjes së kontratës po jo më vonë se data 30.06.2020.
- Financimi I shumës së përfituar bëhet nga bankat e nivelit të dytë,
- I gjithë dokumentacioni I kërkuar të jetë në gjuhën shqipe

Aplikimi për masat nga 1-6 mund të bëhet online ndërsa aplikimi për masën 7 bëhet me dosje në AXHBR.

Fondi i parashikuar në Skemën Kombëtare 2020 është 743,9 milionë lekë.

Burimi: <http://azhbr.gov.al>

3.2. Programi IPARD 11

Instrumenti i Ndhmës së Para-Aderimit (IPA II) 2014 - 2020 është mjeti kryesor i përdorur nga Bashkimi Evropian (BE) për të ofruar mbështetje financiare dhe teknike për vendet e zgjerimit. Objektivi i përgjithshëm i IPA-s për Shqipërinë është të mbështesë reformat dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për të arritur pajtueshmërinë me ligjet e BE-së për të përgatitur plotësisht vendin për të marrë detyrimet e anëtarësimit në BE. IPA ka një fushë të Politikave të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (IPARD II), i cili u ofron ndihmë vendeve kandidate të BE-së për zbatimin e programeve shumëvjeçare që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe zonave rurale dhe përgatitjen e tyre për zbatimin e politikave të BE-së.

Kontributi maksimal i BE për fondet IPARD II në Euro për vitet, 2014-2020;

VITI	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014-2020
TOTALI	-	-	13,000,000	14,000,000	12,000,000	16,000,000	16,000,000	71,000,000

Plani financiar për çdo masë në Euro, 2014-2020

MASAT	TOTALI I MBESHTETJES PUBLIKE (EURO)	KONTRIBUTI I BE-SË (EURO)	PËRQINDJA E KONTRIBUTEVE TË BE-SË (%)	KONTRIBUTI KOMBËTAR	PËRQINDJA E KONTRIBUTIT KOMBËTAR
Investime në asetet fizike në fermat bujqësore	41,866,667	31,400,000	75%	10,466,667	25%
Investime në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të përshkrimit	35,333,333	26,500,000	75%	8,833,333	25%
Masa agro-mjedisore - klimaterike dhe bujqësisë organike	-	-	-	-	-
Zbatimi i strategjive lokale të zhvillimit - LEADER	-	-	-	-	-
Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit	16,666,667	11,000,000	75%	3,666,667	25%
Asistenca teknike	2,470,588	2,100,000	85%	370,588	15%
Shërbimet këshillimore	-	-	-	-	-
TOTALI	94,337,255	71,000,000	-	23,337,255	-

Buxheti i përgjithshëm indikativ në kuadër të Programit IPARD II është gjithsej 94,337,255 EURO nga të cilat 71,000,000 EURO është kontributi i BE dhe 23,337,255 EURO është kontributi kombëtar.

Në kuadër të programit IPARD II, 94 milion EURO nga fondet e Qeverisë Shqiptare dhe Bashkimit Evropian mbështesin financiarisht masat:

Masa 1 – Investime në fermë, me një minimum prej 10 000 EURO dhe maksimum 500 000 EURO. Përqindja e mbështetjes është 60% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit, 65% nëse investimi bëhet nga një fermer i ri (nën 40 vjeç), 70% për investimet në zonat malore.

Masa 3 – Investime për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, me

një minimum prej 25 000 EURO dhe maksimum 2 000 000 EURO. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 50% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Masa 7 – Investime në diversifikimin e ekonomisë në fshat, me një minimum prej 10 000 EURO, maksimumi 400 00 EURO. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 65% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Mnistria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, po përgatitet të hapë thirrjen e tretë në programin IPARD II, pas realizimit të dy thirrjeve të para të këtij programi që financon nga 50-70% të vlerës së investimit për tre masa mbështetëse: Investime në fermë, agropërpunim dhe agroturizëm.

Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë për të gjitha investimet.

1. Të gjitha investimet duhet të bëhen brënda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Përfituesit janë fermerë të pajisur me NIPT-in e fermerit, persona fizikë ose persona juridikë, duke përfshirë kooperativa, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Aplikuesi duhet të dëshmojë se ai/ ajo është pronar i tokës/ ndërtesës që ka të bëjë me investimin ose
4. Aplikuesi duhet të ketë të drejtën ta përdorë atë (Tokë/ndërtesë) për një minimum prej 10 vitesh duke llogaritur nga data kur aplikimi është dorëzuar.
5. Projekti i investimit duhet të lidhet me prodhimin e produkteve parësore bujqësore nga sektorët
6. Para dorëzimit të aplikimit në Agjencinë IPARD, çdo projekt duhet të analizohet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetit publik, sigurisë në punë, standardet minimale kombëtare, do të arrihen nga ndërmarrja në fund të investimit, jo më vonë se para pagesës përfundimtare
7. Kompanitë me aktivitet bujqësor, nga kapitali i të cilave, më shumë se 25% zotërohet nga një person juridik publik nuk janë të pranueshme për të aplikuar.
8. Përfituesi si person fizik ose juridik, përfaqësuesi ligjor apo menaxheri, duhet të kenë diplomë universitare ose diplomë kualifikimi profesional në fushën e bujqësisë apo të lidhura me të (bujqësi, shkencat e veterinarisë, ekonomi bujqësore) ose të paktën 3 vjet pune eksperiencë në prodhimin bujqësor, përpunimin ose shërbime të lidhura me bujqësinë. Përfituesi i cili nuk mundet të plotësojë kërkesat e sipërpërmendura duhet që të marrë përsipër që të ndjekë një trajnim profesional prej 50 orësh mësim në sektorin përkatës përpara pagesës finale.
9. Aplikuesit gjatë dorëzimit të formularit të aplikimit duhet të paraqesin: ■ një propozim teknik për projektin në lidhje me investimet nën 50.000 euro që dëshmon qëndrueshmërinë ekonomike të investimit të projektit në fund të investimit ose ■ një plan biznesi në lidhje me investimet mbi 50.000 euro që dëshmon qëndrueshmërinë ekonomike të investimit të projektit në fund të investimit (përdorni aneksin 2.3 të Udhëzuesit për aplikantët);
10. Aplikanti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e lidhura me pagesën e taksave, përfshirë taksën e tokës, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe nuk duhet të jetë në listën e borxhit të AZHBR-së.
11. Në lidhje me prodhimin e energjisë së rinovueshme (në nivel ferme), masa mbështet vetëm ato

12. Të gjitha pajisjet e blera duhet të jenë të reja.
13. Të gjitha pajisjet e blera në kuadër të këtij programi duhet të kenë origjinë nga një prej vendet në vijim: Shtetet Anëtare, përfituesit e IPA II, palët kontraktuese të Marrëveshjes në Zonën Ekonomike Evropiane dhe vendet partnere të mbuluara nga Instrumenti European i Fqinjësisë, Vendet për të cilat qasja reciproke në asistencën e jashtme përcaktohet nga Komisioni,

Burimi: <http://azhbr.gov.al/>

3.3. Programi AZHBR

ProCredit Bank, BKT, Union Bank, në bashkëpunim me Agjensinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), ofrojnë skema të financimit për mbështetjen e bizneseve bujqësore (prodhuese dhe agropërpunuese), ku subvencionohet norma e interesit të kredisë nga kjo agjenci.

Për kredi deri në shumën 25,000,000 lekë ofrohet subvencionim i normës së interesit deri në masën 70% për 5 vite rresht për shoqëritë që kanë si aktivitete të tyre ruajtjen/ përpunimin e produkteve bujqësore/ blegtorale, kërpudhës, bimëve medicinale.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Dokument ligjor i shoqërisë/Personit Fizik
- Dokument nga Zyra e Tatimeve që vërteton se subjekti nuk ka detyrime tatimore
- "Leter of intend/comfort" për financimin e projektit të lëshuar nga banka
- Dokument nga rregjistri i kredisë që konfirmon se aplikanti nuk ka detyrime ose borxh të keq me institucione të tjera financiare
- Plani i detajuar i biznesit (minimum 5 vjeçar)
- Ofertën për makineritë, linjën e marë në konsideratë nga banka gjatë shqyrtimit të kërkesës për kredi
- Fotokopje të kartës së identitetit ose pasaportës së aplikantit
- Dokumentin e pronësisë për kolateralin e lënë garanci për kredinë e marrë. (kontratë hipoteke për pasuritë e paluajtëshme, kontratë e pengut për makineri dhe paisje të lëna garanci ose dokumentin e pronësisë mbi pasuri të paluajtëshme apo pengje që do të përdoren për kolateral)
- Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, lidhur me shlyerjen korente të sigurimeve shoqërore.
- Vërtetim banke për numrin e llogarisë.

Burimi: <https://www.procreditbank.com.al/sq/azhbr>,
<https://www.unionbank.al/vizioni-yne?id=175>,
<https://bkt.com.al/biznes/ekspertiza-e-industrise/sektori-i-agrikultures>.

3.4. Produktet financiare ekzistuese për agroturizmin nga bankat dhe institucionet financiare në Shqipëri

Aktualisht, sektori po përfiton nga grante të pakthyeshme të ofruara nga skemat kombëtare të AZHBR-së dhe IPARD II dhe do të përfitojë nga programi "100 fshatrat", i cili do të ofrojë fonde dhe asistencë teknike. Sidoqoftë, sektori i agroturizmit ka marrë shumë pak vëmendje nga bankat dhe Nevojat e financimit të agroturizmit 35 institucionet financiare. Kërkesa për kredi për investime pritet të rritet me shpejtësi në agroturizëm dhe bankat dhe institucionet financiare duhet të përgatiten me produkte të dedikuara për të përmbushur këtë kërkesë në rritje.

Intesa San Paolo³ është një nga IFP-të më të rëndësishme që ka shprehur gatishmërinë e saj për të mbështetur sektorin e agroturizmit në Shqipëri dhe ka ndërmarrë disa veprime konkrete në këtë drejtim. Banka ka zhvilluar katër produkte kredie specifike për agroturizmin:

- 1) Kredi për investime për ndërtimin dhe/ose rindërtimin e objekteve akomoduese të agroturizmit dhe blerjen e makinerive;
- 2) kredi për investime në makineri dhe pajisje për të rritur cilësinë dhe larminë e produkteve tipike tradicionale në mbështetje të agroturizmit;
- 3) kredi për investime për ndërtimin e restoranteve të agroturizmit ose rindërtimin e objekteve ekzistuese për të ofruar shërbime hotelierie; dhe
- 4) kapital qarkullues për të mbuluar nevojat e përkohshme të likuiditetit. Për të garantuar menaxhim të mirë të performancës dhe për të mbështetur biznesin e ri, banka i ka përfshirë aktivitetet e kreditimit për agroturizmin te Treguesit Kryesor të Performancës të forcës së saj të shitjes në degë.

Banka Credins⁴ ka zhvilluar një produkt kredie të përshtatur për agroturizmin, të quajtur "Agroturizmi 100". Banka është gjithashtu partnere në një fushatë ndërgjegjëse për "agroturizmin si një potencial për zhvillimin rural" së bashku me MBZHR-në, Universitetin e Firences dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës. Në këto seminare ndërgjegjëse, përfaqësuesit e Bankës Credins prezantojnë produktet e Agroturizmi 100 dhe shprehin gatishmërinë e tyre për të financuar sektorin e agroturizmit. Sidoqoftë, agroturizmin e përfshijnë ende në segmentin e bujqësisë.

Fondi Besa⁵ aktualisht ofron kredi të vogla për bizneset turistike rurale, një produkt i financuar nga "CESVI Albania" në kuadër të projektit "Zana e Maleve". Objektivi përfshin të rinjtë e moshës 18-35 vjeç me ide për të investuar në turizmin rural dhe agroturizmin.

Në vitin 2018, NOA⁶, një institucion i rëndësishëm mikrofinanciar në Shqipëri, promovoi një produkt kredie kushtuar turizmit, më saktësisht turizmit bregdetar, rural/agrar dhe kulturor. Për turizmin rural dhe agroturizmin, produkti është i destinuar për rindërtimin e banesave të vjetra të fermave, duke përfshirë të gjithë mobilimin e nevojshëm, si dhe rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve të agroturizmit. NOA ofron gjithashtu disa stimuj për klientët potencialë të agroturizmit, duke vendosur norma më të ulëta interesi krahasuar me sektorët e tjerë.

Burimi: <https://aasf.com.al/wp-content/uploads/2020/03/Agroturizmi-ALB.pdf>

³<https://www.intesasanpaolobank.al/>

⁴<https://www.bankacredins.com/>

⁵<https://www.fondibesa.com/>

⁶<https://www.noafin.al/individe/kredi-konsumatore>

04

SHËRBBIMET E ZYRËS SË PUNËSIMIT, NË RAPORT ME PUNËDHËNËSIT DHE PUNËMARRËSIT

Në mbështetje të individëve me qëllim punësimin në sektorë të ndryshëm ekonomik, të vetëpunësuarve apo sipërmarrjeve të reja, të individëve të prekur nga situata e COVID-19 zyra e punësimit ka implementuar programe me fokus kapitalin njerëzor. Të gjitha këto programe, kanë themel të fortë ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”. Si më poshtë, japim një platforme të përgjithshme të programeve:

4.1. Programi i punëve publike në komunitet

Është një program 12 mujor, i cili ka qëllim përfshirjen në tregun e punës të punëkërkuesve të papunë afatgjatë nëpërmjet ofrimit të mundësive të trajnimit dhe të punësimit part-time në aktivitete me fokus shërbimet në dobi të komunitetit.

Kriteret e aplikimit për punëkërkuesit

1. Punëkërkuesit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuesit e papunë të regjistruar dhe aktivë, për jo më pak se 12 muaj në zyrën e punës, të moshës mbi 25 vjeç, pasi të kenë marrë shërbimet e nevojshme të punësimit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga specialisti përkatës i punësimit. Nevojat dhe profili i punëkërkuesit duhet të përshtatet me kërkesat për aftësi të vendit të punës që siguron programi për ta.
2. Punëkërkuesit, pjesëmarrës në këtë program, në rast largimi, mund të zëvendësohen vetëm gjatë tre mujorit të parë të programit.
3. Një punëkërkues mund të marrë pjesë vetëm një herë në këtë program brenda një periudhë pesëvjeçare

Kriteret e aplikimit për punëdhënësin

1. Punëdhënësit (të regjistruar në zyrën e punës) me të drejtë përfitimi në këtë program janë:
 - i. organizata jofitimprurëse,
 - ii. organizata vullnetare,
 - iii. organizata të shoqërisë civile,

- iv. biznese sociale/sipërmarrje sociale/ndërmarrje sociale,
- v. organizata publike shtetërore
- 2.** Punëdhënësit duhet të jenë të specializuar në fushat: shërbimet e kujdesit për fëmijët;
 - a) shërbime të kujdesit shëndetësor dhe social;
 - b) shërbime të rehabilitimit të ish-përdoruesve të substancave narkotike;
 - c) punime dhe shërbime për komunitetin dhe mjedisin;
 - d) shërbime këshillimi dhe informacioni;
 - e) shërbime Rinore;
 - f) sport;
 - g) art, turizëm dhe kulturë;
- 3.** Punëdhënësit, duhet të jenë të regjistruar sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe të kryejnë aktivitete në përputhje me qëllimin e përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre, duhet të kenë shlyer detyrimet tatimore, mbartin të gjitha përgjegjësitë dhe detyrimet e mbikëqyrjes dhe punësimit, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.** Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë për maksimumi dy grupe, me numër jo më të madh se 7 punëkërkuar të papunë secili grup.
- 5.** Punëdhënësi ka për detyrë të vendosë një mbikëqyrës për çdo grup përfituesish nga 1 në 14 pjesëmarrës, i cili mund të punojë deri në 40 orë në javë.
- 6.** Në rast largimi të mbikëqyrësit, punëdhënësi është i detyruar ta zëvendësojë atë, duke njoftuar në AKPA, dhe kjo e fundit të japë miratimin. Në rast të kundërt, duhet të kthejë 100% të subvencioneve të përfituara për pjesën e punëdhënësit.
- 7.** Mbikëqyrësi ka për detyrë të ndjekë me përpikmëri mbikëqyrjen e punëkërkuarve pjesëmarrës në program

Mbështetja e përfituesve në prizmin e punëkërkuarve dhe punëdhënëseve

- a) Për punëkërkuarët e papunë pjesëmarrës në program:
 - 1.** Financim i pagës në shumën 50% të pagës minimale në shkallë vendi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
 - 2.** Kupon për trajnim të punëkërkuarve të papunë pjesëmarrës në program deri në 20,000 lekë, në rastet kur trajnimet e miratuara nuk ofrohen nga ofruesit publikë të rsimit dhe formimit profesional.
 - 3.** Për përfituesit jetimë, prindër të vetëm me fëmijë nën 6 vjeç, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, përfitues të ndihmës ekonomike, romë dhe egjiptianë mbulohen edhe shpenzime të tjera si më poshtë:
 - i. bonus për shpenzimet e transportit mbulohen për të gjitha kategoritë e mësipërme; të cilët kanë vendbanimin mbi 2 km nga vendi i punës, në vlerën prej 1,600 lekë në muaj;
 - ii. për prindërit e vetëm me një fëmijë nën gjashtë vje jep një bonus në vlerën prej 3.000 lekë në muaj për ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët në ngarkim.
 - iii. Financim deri në shumën 100.000 lekë (njëqind mijë) por jo më shumë se 200.000

- (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona, për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara
- b) Për punëdhënësin pjesëmarrës në program:
1. Për mbikëqyrësin financim i pagës në shumën:
 - i. 50% të pagës mesatare në shkallë vendi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për grupin nga 1-7 punëkërkues të papunë pjesëmarrës, për 20 orë në javë.
 - ii. 100% të pagës mesatare në shkallë vendi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për grupin nga 1-14 punëkërkues të papunë pjesëmarrës, për 40 orë në javë.
 2. Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës mesatare në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.
 3. Tarifë për mbulimin e shpenzimeve materiale të nevojshme për zbatimin e projekteve të punësimit në komunitet, në shumën totale deri në 10,000 lekë për çdo përfitues, këto të justifikuar me fatura tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

Burimi: Projektvendim, Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet.

4.2. Programi i punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19 nga data 10 mars 2020 deri në datën 23 qershor 2020, nëpërmjet financimit të sigurimeve të detyrueshme.

Kriteret e aplikimit

PËR PUNËKËRKUESIT	PËR PUNËDHËNËSIT
1. Punëkërkuesit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuesit e papunë që kanë dalë të papunë si pasojë e COVID 19, të cilët deklarojnë që kanë qenë të punësuar, por nuk evidentohen si të tillë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe regjistrohen në zyrën e punës. 2. Punëkërkuesi nuk mund të zëvendësohet. 3. Një punëkërkues mund të marrë pjesë vetëm një herë në këtë program.	a) të jenë shoqëri tregtare të regjistruara, b) të jenë subjekt i pagimit të taksave dhe të jenë të regjistruar si punëdhënës pranë autoriteteve tatimore; c) të mos kenë shkelur legjislacionin për punësimin në dy vitet e fundit para shpalljes së gjendjes së pandemisë; d) të ofrojnë punë me kohë të plotë, për një minimum prej 40 (dyzet) orësh në javë, me një pagesë mujore jo më pak se paga minimale; e) vendi i punës i financuar nga ky program duhet të vijë si rezultat i rritjes së fuqisë punëtore në aktivitetin e punëdhënësit; f) të jenë shoqëri tregtare, të cilat nuk kanë detyrime ndaj organeve tatimore para datës 10 mars, në bazë të akteve normative në fuqi, ose, në momentin e aplikimit në program, të vërtetojnë se: i. kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullta në shlyerjen e tyre; ii. kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjokat; iii. kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit dhe janë në proces të apelimit administrativ e në procese gjyqësore me organet tatimore.

Programi, përfituesit dhe mbështetja

1. Programi i punësimit është një program njëvjeçar punësimi, në të cilin profili dhe nevojat e punëkërkuarit përshtaten me vendin e lirë nga punëdhënësi;
2. Paga përcaktohet në kontratën e punës, në përputhje me pozicionin përkatës dhe nivelin e pagave në treg.
3. Programi subvencionon kostot e financimit të sigurimeve të detyrueshme (kontribut i punëdhënësit dhe punëmarrësit) në masën 100 (njëqind) %, të llogarituara në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit, të kompensuara çdo muaj.

Burimi: Projektvendim, Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19

4.3. Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet vetëpunësimit

Është program një vjeçar, me qëllim nxitjen e vetëpunësimit nëpërmjet krijimit të sipërmarrjeve të reja të punëkërkuarve të papunë të interesuar.

Mbulohen shpenzimet për:

- a) grantin për hapjen e biznesit të ri;
- b) vlerësimin e planeve të biznesit.

4.3.1. Kriteret për aplikim, përfituesit dhe mbështetja

Për të aplikuar në program:

- 1) Aplikuesi duhet të jetë punëkërkuar i papunë i regjistruar në strukturën vendore të punësimit;
- 2) Duhet të ketë një ide biznesi, e cila nuk është në kundërshtim me kriteret e konkurrueshmërisë dhe që deklarohet në bazë të një formulari të posaçëm që përmban:
 - i. përshkrimin e idesë së biznesit;
 - ii. relevancën (rëndësinë);
 - iii. burimet e nevojshme për realizimin e biznesit;
 - iv. vlerësimin e gjendjes së mjediseve ku do të zhvillohet biznesi.
- 3) Punëkërkuari duhet të marrë pjesë personalisht në të gjitha hallkat e procesit.
- 4) Punëkërkuari mund të përfitojë vetëm një herë nga programi.
- 5) Shpenzimet për vlerësimin e planit të biznesit të të gjithë pjesëmarrësve, në vlerën jo më shumë se 3000 lekë për çdo plan biznesi, mbulohen nga AKPA-ja (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive), nga zëri i buxhetit "Programet e nxitjes së punësimit".

- 6)** Programi subvencionon të gjithë të përzgjedhurit deri në masën 500'000 lekë.
- 7)** Shpenzimet që nuk mbulohen nga granti i financuar:
- blerja e pasurive të patundshme;
 - çdo shpenzim që nuk lidhet dhe nuk përfshihet në planin e biznesit të miratuar;
 - shpenzimet e kryera përpara nënshkrimit të marrëveshjes së grantit;
 - pagat, shpërblimet, qiraja dhe shpenzimet e tjera administrative.

Burimi: Vendim Nr. 343, datë 29/04/2020 për Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit.

4.4. Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale

Kriteret për aplikim

PËR PUNËDHËNESIT	PËR PUNËKËRKUESIT
a) të jenë shoqëri tregtare të regjistruara, për jo më pak se 6 muaj; b) të mos jenë në proces falimentimi; c) të jenë subjekt i pagimit të taksave dhe të jenë të regjistruar si punëdhënës pranë autoriteteve tatimore; d) të mos kenë shkelur legjislacionin për punësimin në dy vitet e fundit para aplikimit në program; e) të kenë paguar rregullisht të gjitha sigurimet edetyrueshme shëndetësore dhe shoqërore; f) të ofrojnë punë me kohë të plotë, për një minimum prej 40 (dyzet) orësh në javë, me një pagesë mujore jo më pak se paga minimale. Punësimi me kohë të pjesshme ose punët sezonale afatshkurtra nuk përfitojnë subvencionim; g) të jenë shoqëri tregtare, të cilat nuk kanë detyrime ndaj organeve tatimore ose, në momentin e aplikimit në program, të vërtetojnë se: - kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullta në shlyerjen e tyre; - kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjokat; - kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit dhe janë në proces të apelimit administrativ e në procese gjyqësore me organet tatimore; h) vendi i punës i financuar nga ky program duhet të vijë si rezultat i rritjes së fuqisë punëtore në aktivitetin e punëdhënësit; i) nuk duhet të ketë pakësuar numrin e të punësuarve, duke reduktuar fuqinë punëtore brenda 4 (katër) muajve të kaluar. Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë në më shumë se një program për një numër punëkërkuesish jo më të madh se 20 (njëzet) % të fuqisë punëtore aktuale, por jo më shumë se 21 (njëzet e një) pjesëmarrës. Punëdhënësit me më pak se 5 (pesë) punonjës mund të aplikojnë për maksimumi dy pjesëmarrës.	- Punëkërkuesit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuesit e papunë të regjistruar dhe aktivë, për jo më pak se 3 (tre) muaj në zyrën e punës. Nevojat dhe profili i punëkërkuesit duhet të përshtaten me kërkesat për aftësi të vendit të lirë të punës të ofruar nga punëdhënësi. - Punëkërkuesi, pjesëmarrës në programet nuk mund të zëvendësohet. - Një punëkërkues mund të marrë pjesë vetëm një herë në të njëjtin program brenda një periudhe pesëvjeçare

4.5. Programet të tjera

Programi i punësimit

- a) programi i punësimit është një program një vjeçar punësimi;
- b) paga përcaktohet në kontratën e punës, në përputhje me pozicionin përkatës dhe nivelin e pagave në treg;
- c) punëkërkuessit e papunë me të drejtë përfitimi janë nga kategoritë e mëposhtme:
 - i. të rinjtë me moshë nën 29 (njëzet e nëntë) vjeç;
 - ii. punëkërkuessit e papunë afatgjatë;
 - iii. punëkërkuessit me moshë mbi 45 (dyzet e pesë) vjeç;
 - iv. punëkërkuessit e papunë të pakualifikuar;
 - v. punëkërkuess të papunë, të kthyer prej jo më shumë se 2 (dy) vjetësh nga emigracioni;
 - vi. punëkërkuessit që përfitojnë ndihmë ekonomike, duke trajtuar me prioritet përfituesit e ndihmës ekonomike, që parashikohet të dalin nga skema e ndihmës ekonomike në vitin përkatës dhe atë pasardhës;
 - vii. punëkërkuessit që marrin pagesa papunësie për më shumë se 3 (tre) muaj;
 - viii. personat me aftësi të kufizuara;
 - ix. viktimat e trafikimit, të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje;
 - x. punëkërkuessit nga komuniteti rom dhe egjiptian;
 - xi. personat që kanë përfunduar kursin e formimit profesional ose programin e formimit nëpërmjet punës dhe janë ende të papunë 6 (gjashtë) muaj pas përfundimit;
- ç) programi subvencionon kostot e mëposhtme:
 - i. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së punësimit, të kompensuara çdo muaj;
 - ii. financimin e pagës në shumën 100 (njëqind)% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi:
 - për 4 (katër) muaj, për të gjithë pjesëmarrësit në program, të kompensuara në muajin e pestë dhe të gjashtë të kontratës, dhe në muajt e njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të kontratës;
 - për 6 (gjashtë) muaj, për pjesëmarrësit, të cilët janë viktimat e trafikimit, të dhunës në familje apo viktimat e dhunës me baza gjinore, romë dhe egjiptianë, të kompensuara në muajin e katërt, të pestë, të gjashtë, të shtatë, të njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të kontratës;
 - për 12 (dymbëdhjetë) muaj për pjesëmarrësit, persona me aftësi të kufizuara, të kompensuara çdo muaj.

Programi i formimit nëpërmjet punës

- a) ka si qëllim trajnimin në punë të punëkërkuessve, sipas nevojave të profilit të punës të kërkuar nga punëkërkuessit dhe përshtatur me nevojat e punëdhënësit;
- b) kohëzgjatja e subvencionimit do të jetë për një periudhë katërmujore për të gjitha profesionet;

- c)** plani individual i trajnimit hartohet nga punëdhënësi e miratohet nga strukturat përkatëse të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë;
- ç)** çdo punëdhënësi cakton të paktën një trajner për çdo grup përfituesish, nga një deri në shtatë persona përfitues, të përfshirë në program;
- d)** përfitues i këtij programi është punëkërkuuesi i papunë dhe i pakualifikuar në profesionin e interesuar;
- dh)** programi subvencionon kostot e mëposhtme:
 - i. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së formimit, të kompensuara çdo muaj;
 - ii. financimin e pagës në shumën 100 (njëqind)% të pagës minimale në shkallë vendi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të kompensuara çdo muaj;
 - iii. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit) për tetë muajt e ardhshëm, të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, në rastet, kur, pas përfundimit të formimit nëpërmjet punës, punëdhënësi lidh kontratë punësimi të paktën tetëmujore me punëmarrësin pas përfundimit të programit;
 - iv. pagesën për mentorin në vlerën 2 000 (dy mijë) lekë për çdo përfitues, pjesëmarrës të angazhuar nga ky punëdhënësi.

Programi i praktikave profesionale

- a)** ka si qëllim të garantojë tranzicion të shpejtë në tregun e punës, në të njëjtën fushë ose në një fushë të ngjashme me atë, në të cilën ka studiuar i diplomuari, për një kohëzgjatje 6-mujore;
- b)** përfitues janë të gjithë punëkërkuuesit e papunë, të cilët janë të sapodiplomuar, deri në 24 (njëzet e katër) muajt e fundit pas diplomimit, të cilët janë regjistruar si punëkërkuues të papunë;
- c)** programi subvencionon kostot e mëposhtme:
 - i. kontributet për sigurimin nga aksidentet në punë;
 - ii. financim i pagës në shumën 50 (pesëdhjetë)% të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të kompensuara çdo muaj.

Përveç subvencionimit të kostove të mbuluara nga këto programe, për përfituesit jetimë, prindër të vetëm me fëmijë nën 6 (gjashtë) vjeç, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, viktimat e viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, përfitues të ndihmës ekonomike mbulohen edhe shpenzime të tjera, si më poshtë vijnë:

- a)** bonuse për shpenzimet e transportit mbulohen për të gjitha kategoritë e mësipërme, të cilat kanë vendbanimin mbi 2 (dy) km nga vendi i punës, në vlerën prej 1,600 (një mijë e gjashtëqind) lekësh në muaj;
- b)** për prindërit e vetëm me një fëmijë nën 6 (gjashtë) vjeç jepet një bonus në vlerën prej 3 000 (tre mijë) lekësh në muaj për ndjekjen e kopshteve dhe të çerdheve për fëmijët në ngarkim;

- c)** deri në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara për punëdhënësit.

Burimi: FZ nr. 3 dt 20/01/2020, botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Shtojca 1

Kriteret për certifikimin e veprimtarisë pritëse si "Agroturizëm" dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të agroturizmit"

Agroturizmi, si veprimtari, duhet të zhvillohet minimalisht në një nga fermat e mëposhtme:

- a) Fermat bujqësore, të cilat kanë të paktën 1 ha tokë të mbjellë me kultura bujqësore;
- b) Ferma blegtorale, të cilat mbarështojnë, të paktën, 10 krerë gjedhë ose 100 krerë dele/dhi ose 200 krerë shpendë.
- c) Njësitë agrikulturore, të cilat kanë si aktivitete përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës dhe që plotësojnë kriteret⁷ si dhe kriteret në shkronjën "a" e "b" të kësaj pike.

Struktura/objekti akomodues, në funksion të agroturizmit, duhet të ofrojë një kapacitet akomodimi nga 6 deri në 30 dhoma.

Struktura/objekti akomodues dhe pritës, në funksion të agroturizmit, duhet të respektojë:

- a) kushtet e zhvillimit për ndërtim, të përcaktuara në planet e përgjithshme vendore ose në legjislacionin sektorial për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- b) në varësi të llojit të strukturës/objektit, kriteret dhe kushtet e përcaktuara në vendimin nr.730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese", të ndryshuar;
- c) atje ku është e mundur, struktura/objekti duhet të respektojë karakteristikat/gjuhën arkitektonike të zonës.

Kriteret e përcaktuara në këtë vendim shërbejnë dhe janë të detyrueshme për zbatim nga ana e autoriteteve përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit për hartimin e dokumenteve të planifikimit në të gjitha nivelet.

Leja e ndërtimit lëshohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me dokumentin e planifikimit vendor në fuqi dhe legjislacionin sektorial për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Struktura/objekti ku ofrohet ushqim dhe pije duhet të ketë 6 deri në 60 tavolina. Ofrimi i ushqimit dhe i pijeve bëhet në ambiente të përshtatshme dhe duhet të plotësojë kriteret e parashikimeve të legjislacionit në fuqi për sigurinë e ushqimeve dhe kushtet higjienosanitare.

⁷Subjektet, që zhvillojnë veprimtari pritëse të klasifikuara si "agroturizëm", duhet të ofrojnë të gjitha shërbimet e mëposhtme:

a) Akomodim;

b) Ushqim dhe pije;

c) Veprimtari argëtuese/çlodhëse, të lidhura me fermën ose mjedisin përreth.

Ushqimi dhe pijet e ofruara në këto struktura duhet të jenë:

- a)** jo më pak se 30% të sasisë së tyre me origjinë nga ferma;
- b)** jo më pak se 40 % të sasisë së tyre, me origjinë lokale, brenda territorit të bashkisë ku ushtrohet veprimtaria e agroturizmit;
- c)** jo më shumë se 30% e sasisë së tyre me origjinë tjetër.

Subjektet agroturistike ofrojnë/mundësojnë për vizitorët e turistët veprimtari argëtuese/çlodhëse, që lidhen me fermën (si, p.sh., por pa u kufizuar në mbjellje/vjelje të produkteve bujqësore, aktivitete të lidhura me kafshët, peshkim artizanal, degustim të produkteve etj.) ose jashtë fermës (si, p.sh., por pa u kufizuar në hipizëm, alpinizëm, ecje në natyrë etj.)

Subjekti që zhvillon veprimtarinë pritëse të agroturizmit duhet të ofrojë/mundësojë për vizitorët e turistët veprimtari argëtuese/çlodhëse, që lidhen me fermën dhe mjedisin përreth

Të dhëna mbi certifikatën që duhet të pajisen subjektet e agroturizmit

Subjektet, që aplikojnë për marrjen e "Certifikatës paraprake" apo të "Certifikatës", paguajnë një tarifë prej 2 000 (dy mijë) lekësh në llogarinë e ministrisë përgjegjëse për turizmin. Të ardhurat nga këto tarifa derdhen në buxhetin e shtetit.

Bazuar në vendimmarrjen e komisionit, ministri përgjegjës për turizmin lëshon:

- a)** certifikatën paraprake "Për veprimtarinë pritëse të certifikuar si agroturizëm". Kjo certifikatë lëshohet për të bërë të zbatueshëm legjislacionin në fuqi për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe ka vlefshmëri deri në 2 vjet nga dhënia e saj;
- b)** certifikatën "Subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit". Certifikata lëshohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rinovimi, bazuar në kërkesën e subjektit".

Çdo subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit është i detyruar të përdorë në ambientet e tij, në një vend të dukshëm dhe në emërtimin tregtar shenjë dalluese, e cila miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit përfitojnë lehtësira fiskale sipas legjislacionit në fuqi, vetëm pasi të jenë të pajisur me "Certifikatën paraprake" ose "Certifikatën".

Shfuqizimi i certifikatës "Subjekt i certifikuar i agroturizmit" nga komisioni vlerësues, në rastin kur veprimtaria nuk përdoret për qëllime agroturizmi dhe subjekti ka përfituar lehtësira fiskale përjashtuese (si taksa infrastrukturës etj.), detyron subjektin që t'i kthejë këto përfitime. Përlllogaritja bëhet nga organet tatimore/njësitë e vetqeverisjes vendore."

Burimi: <http://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Vendim.pdf>

